



## SBS kerkon mendimin e komunitetit per te formuluar te ardhmen e SBS Radio dhe sherbimeve ne gjuhe te ndryshme

Si pjese e planit per t'i sherbyer nevojave gjithnje ne ndryshim te komuniteteve te ndryshme, SBS do te rifilloje rishikimin e programacionit te saj radiofonik ne gjuhe te huaja. Me kete rast ftojme publikun qe te jape mendimin e tij ne lidhje me kriteret e seleksionimit.

Rishikimi i Programacionit te SBS ne Gjuhe te Huaja eshte nje proces qe zhvillohet nje here ne pese vjet dhe menjehere pas Regjistrimit te Popullsise. Qellimi eshte qe programet te pasqyrojne ndryshimet qe ka pesuar komuniteti Australian gjate kesaj periudhe. Programacioni do te perzgjedhe gjuhet ne te cilat do te jape programe SBS gjate pese viteve te ardhshme.

Rishikimi do te sjelle nje programacion te ri ne te gjitha platformat e SBS, radio, SBS On Demand, podcast dhe platforma te tjera digjitale.

Periudha gjashte javore e konsultimit me publikun do te filloje sot dhe do te zgjase deri ne daten 12 Nentor dhe eshte mundesia me e mire qe kane komunitetet per te dhene mendimin e tyre rreth se ardhmes se programeve ne gjuhe te ndryshme. Te gjitha mendimet e dhena do te merren ne konsiderate ne vendimmarrje.

Drejtori i SBS per Audio dhe Gjuhet e Huaja, David Hua, tha, "SBS ka nje aftesi te vecante per t'u lidhur me komunitetet e ndryshme ne Australi. Per me shume se 45 vjet ne kemi qene dhe jemi ne gjendje qe te zhvillohemi dhe te ndryshojme per t'i sherbyer komunitetit dhe ne e bejme kete me ane te radios, sherbimeve online, podcasts dhe aplikacioneve ne me shume se 60 gjuhe te huaja. Ky rishikim do te riformoje SBS nderkohe qe i afrohem i pervjetorit te saj te 50-te.

"Roli kryesor i SBS dhe sherbimeve ne gjuhe te ndryshme pati shume rendesi gjate COVID-19 ku ne ishim ne gjendje qe te sillnim lajme dhe informacione te rendesishme ne gjuhe te ndryshme. Rishikimi i Programacionit ne Gjuhe te Ndryshme eshte nje mundesi kritike qe do te na lejoje qe te vazhdojme t'i sherbejme komuniteteve Australiane.

"Ndryshimet e rregullta te programacionit i japin mundesi SBS qe t'i sherbeje me mire komuniteteve me te medha nga kultura dhe prejardhje te ndryshme dhe atyre me nevoja te vecanta. Ne duam te degjojme zerin e degjuesve dhe ky element eshte kritik e per kete arsye ne i inkurajojme te gjitha qe te japin mendimin e tyre."

Kriteret e seleksionimit do te finalizohen ne Maj 2022 dhe programacioni i ri do te filloje ne fund te 2022. Periudha e konsultimit me publikun do te jete nga 5 Tetori deri ne 12 Nentor 2021. Per te pare kriteret e seleksionimit, shkoni ne [sbs.com.au/consultation](https://www.sbs.com.au/consultation).



Fund.

Per me shume informacion dhe per intervista kontaktoni:  
Kate Warnock | [kate.warnock@sbs.com.au](mailto:kate.warnock@sbs.com.au) | 0419 316 135